

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6271  
E martë, 23 mars 2021  
çmimi 0.40

## Për 24 orë, 16 të vdekur nga Covidi në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KONSTITUOHET LEGJISLATURA E TETË E KUVENDIT TË KOSOVËS

FAQE 4-5

# VOTOHET QEVERIA KURTI 2



Ditën që janë betuar deputetët e legjislaturës së tetë kanë konstituuar Kuvendin, kanë zgjedhur kryeparlamentar Glauk Konjufcën dhe nënkryetarët e rinj. Pas marrjes së detyrës,

kryeparlamentari i ri, njëherësh ushtrues i detyrës i presidentit, Konjufca, nëpërmjet një letre i ka kërkuar Lëvizjes Vetëvendosje propozimin e mandatarit për kryeministër. Më pas kryesia e

Kuvendit ka thirrur seancën dhe në orët e mbrëmjes deputetët e koalicionit qeverisës kanë votuar qeverinë e drejtuar nga Albin Kurti, e cila mori 67 vota për dhe 30 ishin kundër

## OPINION

### TAKIMI NË ZYRËN E ENVERIT

F. 10

Shkruan:  
Bedri ISLAMI



### KOSOVA NËN CIPËN E SERTË TË NJË ANGLEZI

F. 11

Shkruan:  
Ismail SYLA



## AKTUALE



### SHQIPËRIA FURNIZOHET ME 10 000 VAKSINA NGA RUSIA

F. 7

### ISMAJLI: GJENDJA ME COVID-19 NË GJILAN, ALARMANTE

F. 6

## EKONOMI



### BQK-ja SHËNON JAVËN NDËRKOMBËTARE TË PARASË

F. 9

## KRIKOHEN THIRRJET PËR REGJISTRIM TË DIASPORËS SHQIPTARE

FAQE 3



### DAVENPORT, SHEF I RI I OSBE-së NË KOSOVË

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVIC  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

F. 9



## Bullgaria dëbon dy diplomatë ruse

**SOFJE, 22 MARS** - Qeveria e Bullgarisë ka dëbuar dy diplomatë rusë. Atyre u është dhënë kohë 72 orë për ta lëshuar vendin. Më 19 mars autoritetet bullgare njoftuan se kishin shkatërruar një grup spiunimi që i dërgonte Rusisë informacione sekrete ushtarake. Prokurorët thanë se gjashtë persona, përfshirë ish-oficerë të inteligjencës dhe oficerë të tanishëm ushtarakë, ishin akuzuar për dërgimin e informacionit të

klasifikuar në lidhje me Bullgarinë, NATO dhe BE-në në Ambasadën Ruse në Sofje. Ministria e Jashtme e Bullgarisë i shpalli diplomatët rusë të padëshiruar "persona non grata" më 22 mars sepse ata kishin kryer "aktivitete që nuk janë në pajtim me statusin e tyre diplomatik". Ambasada Ruse në Bullgari e quajti vendimin "të pabazë" dhe tha se Moska "rezervon të drejtën e hakmarrjes". Bullgaria ka lidhje të ngushta

kulturore, historike dhe ekonomike me Rusinë. Moska është partnerja kryesore energjetike e vendit. Por, raportet mes dy vendeve janë lëkundur nga disa skandale spiunimi në vitet e fundit. Bullgaria është vend anëtar i NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Që nga tetori i vitit 2019, Bullgaria ka dëbuar pesë diplomatë dhe punonjës të Ambasadës Ruse të akuzuar për spiunim.



## Hungaria miraton për përdorim vaksinën e re të Kinës

**BUDAPEST, 22 MARS** - Autoritetet hungareze kanë miratuar për përdorim emergjent vaksinën e Kinës kundër Covid-19, CanSino Biologics. Hungaria është bërë vendi i parë anëtar i Bashkimit Evropian që e miraton këtë vaksinë. Ky vend ka shënuar rritje të numrit të të infektuarve me koronavirus. Instituti Kombëtar i Farmacisë dhe Ushqimit i Hungarisë (OGYEI), gjithashtu miratoi për përdorim CoviShield, versioni indian i vaksinës "AstraZeneca",



tha shefja e Qendrës Kombëtare për Shëndet Publik të Hungarisë, Cecilia Muller. "Ne jemi në një garë me kohën."

Do të kërkojmë në të gjitha anët e botës për sa më shumë doza të vaksinave të duhura, efikase dhe të sigurta", ka thënë ajo. Nëse të dyja vaksinat miratohen, gjithashtu për përdorim masiv nga Qendra Kombëtare e Shëndetit, Hungaria do të sigurojë shtatë burime nga të cilat mund të sigurojë vaksina. Ky vend tashmë po përdorë vaksinën e Kinës, atë të Rusisë si dhe vaksinat e vendeve perëndimore.

Hungaria po shënon rritje rekorde të shtrimeve në spital. Rritja e numrit të të infektuarve përbën sfidë për kryeministrin e krahut të djathtë, Viktor Orban, i cili u zotua t'i lehtësojë masat e ashpra të bllokimit pasi numri i të vaksinuarve të arrijë në 2.5 milionë, ose 25 për qind e popullsisë së Hungarisë. Deri më tani vetëm 16 për qind e popullsisë, ose 1.59 milionë njerëz kishin marrë dozën e parë të vaksinës, njoftoi zyrtarja shëndetësore Cecilia Muller.

## Trumpi planifikon të kthehet në mediat sociale

**UASHINGTON, 22 MARS** - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do të kthehet së shpejti në mediat sociale "me platformën e tij", tha këshilltari i tij. "Mendoj se do ta shohim presidentin Trump në mediat sociale brenda dy apo tre muajsh", tha Jason Miller për "Fox News". Sipas tij, "platforma do të jetë bileta më e nxehtë në mediat sociale" dhe "do ta ripërcaktojë plotësisht lojën". Trump është përjashtuar nga "Twitter" dhe "Facebook" pas sulmit vdekjeprurës të 6 janarit në ndërtesën e Kongresit Amerikan.

Pesë njerëz, përfshirë një zyrtar policor, janë vrarë në sulmin e mbështetësve të ish-presidentit. Disa ditë më vonë "Twitter" ka thënë se llogaria e Trumpit "është pezulluar përgjithmonë... për shkak të rrezikut të nxitjes së mëtejshme të dhunës". Trumpi e ka përdorur "Twitter"-in për më shumë se 10 vjet si mënyrë për të anashkaluar mediat tradicionale dhe për të folur drejtpërdrejt me votuesit. Milleri nuk sqaroi se çfarë platforme do ta përdorë Trumpi. "Kompani të shumta tashmë i janë drejtuar ish-presidentit", tha ai.



## Lira turke bie pas shkarkimit të guvernatorit

**ANKARA, 22 MARS** - Monedha turke ra për 14 për qind, pasi presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, shkarkoi guvernatorin e Bankës Qendrore në fundjavë. Naci Agbal u cilësua forca kryesore pas rritjes së lirës nga nivelet e ulëta historike. Erdogani e shkarkoi atë të shtunën, vetëm katër muaj pas emërimit. Për vendimin nuk u dha asnjë arsye, por ai ndodhi vetëm një



ditë pasi Banka Qendrore rriti ndjeshëm normën kryesore të interesit, për herë të tretë në pesë muaj - nga 17 në 19 për qind - në përpjekje për ta kontrolluar inflacionin dyshifror. Rritja e normës e interesit ishte mirëpritur nga tregjet, por ishte kundër pikëpamjes së Erdoganit, se normat e larta të interesit shkaktojnë inflacion. Në vend të Agbalit, Erdogani

emëroi ish-ministrin e Financave, Sahap Kavcioglu, njëherësh ish-ligjvënës i partisë në pushtet. Kjo rriti shqetësimet e investitorëve për ndërhyrjen e mundshme të politikës në çështjet monetare. Dobësimi i lirës mund ta përkeqësojë inflacionin, pasi Turqia, për sektorin e saj industrial, varet nga importimi i energjisë dhe mallrave me çmim në dollarë.



# Kritikohen thirrjet për regjistrim të diasporës shqiptare

SHKUP, 22 MARS - Thirrjet e politikanëve nga Kosova, drejtuar diasporës shqiptare, për t'u regjistruar në procesin e regjistrimit të popullsisë që ka nisur në Maqedoninë e Veriut fillimisht me shtetasit që jetojnë jashtë vendit, kanë nxitur reagime të shumta brenda këtij vendi. "Meqë edhe me Kushtetutën aktuale, të drejtat politike të qytetarëve në Maqedoninë e Veriut diktohen dhe burojnë nga numrat, regjistrimi i çdo qytetari është tejet i rëndësishëm", u ka thënë mërgimtarëve, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Kurti ka thënë se qendrat e LV-së, që ndodhen në shtetet e ndryshme në Evropë dhe gjetiu, do të vendosen në shërbim të shqiptarëve të cilët janë shtetas të Maqedonisë së Veriut, nëse ata kanë nevojë për ndihmë gjatë regjistrimit.

Mesazhe të ngjashme për pjesëmarrje në regjistrimin e popullsisë kanë dërguar edhe Vjosa Osmani, kandidatë për pozitën e presidentit të Kosovës, ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj dhe ai i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Thirrjet e tilla liderët e opozitës maqedonase i kanë vlerësuar ndërhyrje në punët e brendshme të Maqedonisë së Veriut. Opozita maqedonase ka reaguar edhe ndaj takimeve që ka realizuar zëvendëskryeministri maqedonas Artan Grubi me zyrtarë të lartë të Kosovës për çështjen e regjistrimit. Ata kanë thënë se regjistrimi është shndërruar në operacion politik, në vend se të jetë statistikor, andaj edhe kanë kërkuar urgjentisht anulimin e regjistrimit.

Opozita maqedonase "E Majta" (Levica) i ka konsideruar thirrjet e Kurtit si ndërhyrje flagrante në politikëbërjen e Maqedonisë së Veriut. "Thirrja nga ana e zyrtarëve të Kosovës, drejtuar diasporës shqiptare, që ajo në mënyrë masive të regjistrohet, paraqet dëshmi flagrante për përzjerje në punët e brendshme në Maqedoni (të Veriut).



Problem shtesë paraqet edhe numri i madh i letërnjoftimeve për të cilat ka dyshime se u janë shpërndarë në rrethana të dyshimta shtetasve të Kosovës", theksohet në reagimin e partisë maqedonase në opozitë "E Majta".

Lidhur me këtë çështje ka reaguar edhe kryetari i Konceptit Maqedonas, Petar Bogojeski, me ç'rast, siç ka theksuar ai, në një status në profilin e tij në "Facebook", Albin Kurti duhet ta shohë oborrin e vet. "Albin Kurti duhet ta shohë oborrin e vet në Kosovë. Kjo është ndërhyrje në punët e brendshme të Maqedonisë (së Veriut) dhe është e papranueshme. Artan Grubi bën thirrje të regjistrohen shqiptarët dhe harron se është zëvendëskryeministër i Maqedonisë (së Veriut) dhe të gjithë qytetarëve të shtetit. Bujar Osmani bën turne me para shtetërore që të regjistrohen shqiptarë dhe harron se Ministria e Punëve të Jashtme është e Maqedonisë (së Veriut) dhe se duhet të takohet me të gjithë nga diaspora e shtetit maqedonas", ka thënë Bogojeski. Për opozitën maqedonase janë

të papranueshme takimet që ka realizuar së fundmi edhe ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, me qëllim të sensibilizimit të diasporës që të përfshihet në procesin e regjistrimit. "Qytetarët tanë vdesin teksa regjimi vrapon pas realizmit të marrëveshjeve politike", kanë theksuar disa zyrtarë nga partia maqedonase në opozitë VMRO-DPMNE, duke kërkuar që regjistrimi të shtyhet për në vjeshtë, kur regjistruesit do të mund të imunizohen me vaksina kundër koronavirusit.

Por, Ilmi Semami, zëvendësdrejtor i Entit Shtetëror të Statistikave, thotë se nuk ka asgjë kontestuese për angazhimin e zëvendëskryeministrit Artan Grubi dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Bujar Osmani dhe zyrtarëve të lartë të Kosovës në sensibilizimin e diasporës, që në numër sa më të madh të përfshihet në procesin e regjistrimit. "Puna e tyre (zyrtarëve të Maqedonisë së Veriut, Grubit dhe Osmanit) ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm, sepse nuk është vetëm një takim, por kjo ka

implikuar dhe thirrjet apo apelet që kanë bërë personat shumë të rëndësishëm në Republikën e Kosovës. Zëvendëskryeministri Artan Grubi udhëtoi edhe drejt Shqipërisë, ku do të takojë politikanë dhe figura me ndikim edhe atje, me qëllim të sensibilizimit të diasporës për t'u regjistruar", thotë Selami. Edhe opozita shqiptare thotë se ndihma e zyrtarëve të lartë të Kosovës është shumë e rëndësishme për faktin se më shumë të drejta të shqiptarëve lidhen me përqindjen e përkatësisë etnike të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. "Sa iu takon thirrjeve për regjistrim nga shumë eksponentë politikë të Kosovës, për regjistrimin e diasporës shqiptare, vlerësoj se nuk ka asgjë për t'u habitur, për arsye të peshës dhe rëndësisë që e ka regjistrimi i popullatës, përkatësisht numri i shqiptarëve, për arsye se pozita juridike kushtetuese dhe zhvillimi socio-ekonomik i tyre fatkeqësisht dhe çuditërisht është i varur dhe i lidhur nga përqindja", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Elmi Aziri, deputet i opozitës shqiptare

Aleanca për Shqiptarët - Alternativa.

Por, nga Enti Shtetëror i Statistikave thonë se procesi i regjistrimit të diasporës po zhvillohet pa problem, ndërkohë që janë regjistruar më shumë se 120 mijë shtetas të Maqedonisë së Veriut në diasporë, duke nënvizuar se presin që të përshpejtohet dinamika e regjistrimit nga vetë mërgata gjatë ditëve në vijim. Ilmi Selami, zëvendësdrejtor i Entit Shtetëror të Statistikave, thotë se në bazë të kësaj situatë, dikasteri që ai drejton pret që deri më 21 prill të regjistrohen më shumë se 300 mijë qytetarë shtetas të Maqedonisë së Veriut të cilët gjenden jashtë vendit.

Të gjithë qytetarët me nënshtetësi të Maqedonisë së Veriut, të cilët jetojnë jashtë vendit, mund të regjistrohen vetë deri më 21 prill të këtij viti. Nëse këtë nuk arrijnë ta bëjnë vetë këtë gjë, atëherë regjistrimin e tyre mund ta bëjnë të afërmit, të cilët ndodhen në Maqedoninë e Veriut gjatë realizimit të procesit të regjistrimit. Ky proces fillon më 1 prill dhe zgjat deri më 21 prill.



## Davenport, shef i ri i OSBE-së në Kosovë

PRISHTINË, 22 MARS - Diplomati britanik Michael Davenport u emërua shef i ri i Misionit në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Me këtë rast, Davenport ka thënë se OSBE-ja "ofron mbështetje të shkëlqyeshme për të drejtat e njeriut, demokratizimin dhe sigurinë publike në Kosovë"

dhe se "është privilegj" për të ta udhëheqë misionin në fjalë. "E mirëpres punën në partneritet me të gjitha palët e interesit për zbatimin e mandatit të misionit", ka deklaruar ambasadori Davenport. Davenport ka përvorë të gjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, pasi ka shërbyer ambasador i Bashkimit

Evropian dhe shef i delegacionit të BE-së në Serbi nga viti 2013 deri më 2017 dhe ambasador i Britanisë në Serbi nga viti 2010 deri më 2013. Ambasadori Davenport është shefi i tetë me radhë i Misionit të OSBE-së në Kosovë që nga themelimi në vitin 1999 dhe e pason ambasadorin Jan Braathu nga Norvegjia.





KONSTITUOHET LEGJISLATURA E TETË E KUVENDIT TË KOSOVËS

# Votohet Qeveria Kurti 2

Ditën që janë betuar deputetët e legjislaturës së tetë kanë konstituuar Kuvendin, kanë zgjedhur kryeparlamentar Glauk Konjufcën dhe nënkryetarët e rinj. Pas marrjes së detyrës, kryeparlamentari i ri, njëherësh ushtrues i detyrës së presidentit, Konjufca, nëpërmjet një letre i ka kërkuar Lëvizjes Vetëvendosje propozimin e mandatarit për kryeministër. Më pas kryesia e Kuvendit ka thirrur seancën dhe në orët e mbrëmjes deputetët e koalicionit qeverisës kanë votuar qeverinë e drejtuar nga Albin Kurti, e cila mori 67 vota për dhe 30 ishin kundër

bashku dhe në emër tuajin, po i falënderojmë qytetarët e Republikës së Kosovës meqë pa votuar ata, ne nuk do mund të vinim këtu. Na priftë e mbarë dhe e shpall të mbyllur këtë seancë! Për seancën e zgjedhjes së qeverisë do tju lajmërojmë me kohë, ka deklaruar Konjufca.

Pas mbylljes së seancës konstituive, kryetari i ri i Kuvendit, njëherësh u. d. i presidentit, ka pranuar detyrën nga paraardhësja e tij, Vjosa Osmani. Kjo e fundit, Konjufcës dhe Kryesisë së Kuvendit, i ka uruar punë të mbarë në udhëheqjen e institucionit më të lartë legjislativ e përfaqësues të vendit tonë. Ishte nder i jashtëzakonshëm që përgjatë legjislaturës së shtatë të jem në krye të Kuvendit, tempullit të demokracisë dhe të punoj duke përfaqësuar interesin e qytetarëve dhe duke rritur integritetin e transparencën në këtë institucion. Dita e sotme është realizim i vullnetit qytetar të shprehur me votë plebishitare në zgjedhjet e 14 shkurtit. Të

gjitha deputeteve dhe deputetëve u uroj punë të mbarë, duke uruar që të jenë përherë të udhëhequr nga kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe të punojnë gjithnjë në shërbim të më të mirës për ta. Na priftë e mbara!, ka shkruar Osmani në profilin e vet në Facebook.

## Kurti paraqet prioritetet

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër, Albin Kurti, fillimisht para deputetëve ka paraqitur prioritetet e qeverisë. Gjatë paraqitjes së ekspozesë para deputetëve ai ka thënë se pandemia mbetet sfida serioze, duke shtuar se menjëherë do të ketë një plan për ta luftuar pandeminë. Brenda vitit synojmë sigurimin e vaksinave për 60 për qind të popullsisë, ka deklaruar Kurti, duke përmendur edhe prioritetet e tjera. Drejtësia, shëndetësia, arsimi dhe ekonomia kanë nevojë për reformë e cila duhet të fillojë shpejt, ka thënë Kurti.

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

**Prishtinë, 22 mars** - Republika e Kosovës të hënën është bërë me Kuvend dhe Qeveri. Deputetët e legjislaturës së tetë, pasi betimit, me 69 vota për, 33 kundër dhe asnjë abstenim, kanë zgjedhur kryetar të Kuvendit të Kosovës nënkryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, i cili nuk votuar nga deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe ata të Listës Serbe. I vetmi deputet i PDK-së që ka votuar për kryeparlamentar Glauk Konjufcën ka qenë Xhavit Haliti.

Më pas deputetët kanë kompletuar edhe kryesinë, duke zgjedhur nënkryetarët. Nënkryetar nga LV-ja është zgjedhur Saranda Bogujevci, nga PDK-ja Bedri Hamza dhe nga LDK-ja Kujtim Shala. Nënkryetarët e partive me shumicë shqiptare janë zgjedhur me 107 vota për dhe gjashtë vota kundër, kurse nënkryetar nga komuniteti serb është zgjedhur Sllavko Simiq, kurse nënkryetar i pakicës joserbe është zgjedhur deputeti Bekim Arifi. Nënkryetarët nga komunitetet janë zgjedhur me 91 vota për, gjashtë kundër dhe dhjetë

abstenime. Seanca konstituive është kryesuar nga deputeti më i vjetër në moshë, Avni Dehari (LV), i shoqëruar nga deputetja më e re në këtë legjislaturë, Adelina Grainca (PDK). Pas marrjes së detyrës, kryeparlamentari Glauk Konjufca ka falënderuar qytetarët për besimin që i kanë dhënë. Ai ka deklaruar se detyrën e tij do ta kryejë me nder dhe përgjegjësi. Për mua nuk do të ketë deputetë të kësaj apo asaj partie. Për mua si kryetar i Kuvendit do të ketë deputetë të barabartë të popullit të Kosovës, sepse kështu jeni. Të gjithë së



## KËTA JANË MINISTRAT E QEVERISË KURTI 2

Kandidati për kryeministër, Albin Kurti, në ekspozenë e tij para deputetëve ka paraqitur edhe kabinetin qeveritar.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë  
Donika Gërvalla, zëvendëskryeministër e dytë dhe ministër e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës

Emilja Rexhepi, zëvendëskryeministër për pakica  
Albulena Haxhiu, ministër e Drejtësisë

Liburn Aliu, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe i Infrastrukturës

Hekuran Murati, ministër i Financave

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë

Arbërie Nagavci, ministër e Arsimit

Hajrullah Çeku, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Artane Rizvanolle, ministër e Ekonomisë

Rozeta Hajdari, ministër e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Faton Peci, ministër i Bujqësisë

Elbert Krasniqi, ministër i Administrimit dhe Pushtetit Lokal

Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme

Goran Rakiq, ministër për Komunitete dhe Kthim

Fikrim Damka, ministër i Zhvillimit Rajonal

# PDK-ja nuk e voton Vjosa Osmanin për presidente

Ushtuesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, i cili është edhe deputet i Kuvendit të Kosovës, ka deklaruar se PDK-ja nuk do ta votojë Vjosa Osmanin për presidente. Zonja Osmani nuk është faktor unifikues për qytetarët e Kosovës. Është faktor përçarës. Nuk e bashkon skenën politike, ka deklaruar ai pas seancës konstitutive. Ai i bëri thirrje kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, që sa më shpejt të zgjidhen Qeveria e Kosovës dhe presidenti. Sikurse sot që është zgjedhur kryesia e Kuvendit dhe është konstituuar Kuvendi, të formohet edhe qeveria dhe të zgjidhet



presidenti. Natyrisht që këtu askush nuk duhet të llogarisë në votën dhe mbështetjen e PDK-së, ka deklaruar Hoxhaj.

Kurse deputeti i zgjedhur i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Driton Selmanaj, ka thënë se në këtë parti ka mendim ndryshe ku jepen vlerësime për situata të caktuara. Ai për votimin e Vjosa Osmanit për presidente ka thënë se brenda LDK-së ka mendime dhe qëndrime për këtë çështje. Selmanaj ka thënë se lidhur me këtë çështje do të shihet kur të vijë radha. Absolutisht ska. Kemi mendime ndryshe. Japim vlerësime për situata të caktuara. Ta shohim kur të vijë radha. Kemi mendime dhe qëndrime edhe për këtë çështje, është shprehur Selmanaj.



## Szunyog: Shpresoj të shoh një Kuvend funksional

Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka mirëpritur konstituimin e legjislaturës së tetë të

Kuvendit të Kosovës. Në llogarinë e tij në Twitter, ai ka shkruar se shpreson të shoh një Kuvend funksional. Mirëpres

formimin e Kuvendit të Kosovës. Është thelbësore që deputetët të bashkohen rreth objektivave të përbashkëta dhe ti

adresojnë çështjet e ngutshme për Kosovën. Shpresoj të shoh një Kuvend funksional dhe konsensus politik për

agjendën evropiane dhe të gjitha çështjet me interes të qytetarëve. Më të fortë së bashku, ka shkruar Szunyog.



## Kastrati përgëzon banorët e fshatit Topanicë për pastrimin e lumit

Kamenicë, 22 mars (ER) - Kryetari Qëndron Kastrati së bashku me Shefen e Sektorit të Emergjencave në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Florentina Kryeziu, kanë vizituar fshatin Topanicë ku janë takuar me kryetarin e Këshillit Lokal Mumin Zubaku, dhe disa nga banorët e këtij fshati.

I pari komunës ka përgëzuar banorët e këtij fshati të cilët

kanë pastruar lumin, duke thënë se fshati Topanicë është gjithmonë i organizuar për secilën çështje që prekë interesin e të gjithë banorëve. "Kamenica është një nga qytetet ku iniciativat e qytetarëve për të mirën kolektive, janë gjithmonë të pranishme. Marrë parasysh që çështja e buxhetit po na e pamundëson intervenimin si komunë, banorët e fshatit Topanicë

kanë bërë pastrimin e shtratit të lumit, për çka edhe kam nxjerrë vendim që të kenë të drejtë intervenimi. Topanica si gjithmonë e organizuar, për secilën çështje që prekë interesin e gjithë banorëve të këtij fshati. Ju lumtë", është shprehur ai. Gjatë vizitës të pranishëm ishin edhe zyrtarët nga DMSH Shaban Canaj dhe Skender Basha si dhe zyrtari Xhevdet Zylfiu nga Prokurimi.



## Jashari e Shoqatat e dala nga lufta, bënë homazhe te varri i dëshmorit Ali Dibran Ahmeti

Skenderaj, 22 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, bashkë me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, asamblistë, familjarë të

dëshmorit e qytetarë, në 22-vjetorin e rënies bënë homazhe e nderime tek varri i dëshmorit Ali Dibran Ahmeti, në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë. Kryetari

Jashari para të pranishmëve shprehi mirënjohjen e thellë ndaj dëshmorit Ali Dibran Ahmeti dhe gjithë dëshmorëve e martirëve të rënë për Lirinë e Kosovë.

## Ismajli: Gjendja me Covid-19 në Gjilan është alarmante

Gjilan, 22 mars (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit.

Nënkryetari Ismajli ka thënë se gjendja në Gjilan në ditët e fundit është alarmante, duke njoftuar se aktualisht janë 476 raste aktive, 94 prej të cilëve po trajtohen në spital. Ai u ka bërë thirrje

qytetarëve dhe bizneseve që japin shërbime që të vazhdojnë t'i respektojnë masat, mbajtjen e maskës dhe mbajtjen e distancës sociale.

Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 16 256 mostra, 4 486 kanë rezultuar pozitivë, 3 894 janë shëruar, 117 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 476 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 94 persona.



## Mbahet debati për ndryshimin e rregullores për orarin e punës të bizneseve në Podujevë

PODUJEVË, 22 MARS (ER) - Të hënën është mbajtur debat publik për propozim rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Në debatin e organizuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik e Komunës së Podujevës, ku ishin të pranishëm përfaqësues të bizneseve të ndryshme, u zhvillua debat për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Drejtori i Drejtorisë për



Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, Pajtim Balaj, i ka njoftuar të pranishmit në debat lidhur me draftin e Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për orarin e punës për bizneset.

Drejtori Balaj ka thënë se draftimi i kësaj rregulloreje bëhet me kërkesën e shumë bizneseve që operojnë në këtë komunë. Përfaqësuesit e bizneseve në debat dolën me propozime të ndryshme rreth orarit të punës të bizneseve të ndryshme.

Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2021 ka miratuar vendimin për vënie në

diskutim publik të Propozimrregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Në kuadër të vendimit, përkatësisht diskutimit/debatit publik të përshihet në tërësi edhe Rregullorja bazë për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, për të cilën mund të jepen propozime, sugjerime dhe vërejtje eventuale për plotësimndryshimin e saj. Diskutimi publik zgjat 30 ditë, përkatësisht nga data 15 mars 2021 deri më 15 prill 2021.



## Për 24 orë, 16 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Të hënën në Kosovë janë shënuar edhe 16 viktima nga Covid-19. Me këtë shifër numri i përgjithshëm i viktimitave ka arritur në 1 776. Në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) thuhet se janë regjistruar edhe 827 raste të reja me Covid-19, bazuar në 5 049 mostra të testuara

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 22 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 5 049 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 827 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 16 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prizren tri raste (87, 71, 62 vjeç), Ferizaj dy raste (58, 82 vjeç), Gjakovë dy raste (73, 76 vjeç), Mitrovicë dy raste (72, 60 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (53 vjeç), Kamenicë një rast (79 vjeç), Lipjan një rast (84 vjeç), Obiliq një rast (62 vjeç), Pejë një rast (72 vjeç), Prishtinë një rast (76 vjeç) dhe Viti një rast (vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 83 012 raste nga 389 791 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 776 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 518

pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 68 601 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 635.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 274 raste, Gjilan 66 raste, Prizren 54 raste, Vushtrri 50 raste, Fushë-Kosovë 39 raste, Pejë 39 raste, Lipjan 34 raste, Gjakovë 33 raste, Kamenicë 33 raste, Ferizaj 29 raste, Mitrovicë 25 raste, Klinë 24 raste, Obiliq 23 raste, Podujevë 22 raste, Viti 16 raste, Deçan 11 raste, Drenas 8 raste, Kaçanik 8 raste, Malishevë 7 raste, Rahovec 7 raste, Suharekë 7 raste, Skenderaj 6 raste, Shtime 4 raste, Dragash 3 raste, Novobërdë 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Hani i Elezit dhe Partesh.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe i të vdekurve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. "Mjekët të

stërngarkuar në spitale po luftojnë kundër këtij virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale e njerëzore. IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19.

Masat parandaluese janë të njëjta, me theks të veçantë se personat pozitivë duhet të qëndrojnë në shtëpi për ta parandaluar përhapjen në familje dhe në komunitet. Me zvogëlimin e kontakteve do ta bëjmë të mundur ndërprerjen e përhapjes së infeksionit", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

Ky institut ka bërë thirrje që të respektohen këto rekomandime: 1. Të qëndrohet në shtëpi dhe dalja të jetë vetëm për nevoja të domosdoshme; 2. Ndalimi rigoroz i takimeve me njerëz me të cilët nuk jetoni në bashkësi, pos për qëllime specifike; 3. Ndalimi rigoroz i tubimeve; 4. Respektimi

rigoroz i masave kufizuese në aktivitete publike; 5. Kufizimi i punës për veprimtaritë joesenciale dhe vendngjarjet duke reduktuar edhe kohën e punës gjatë ditës.

IKShPK-ja vlerëson se këto masa mund ta ndërpresin rritjen e numrit të rasteve, ta parandalojnë mbingarkesën e hospitalizimeve dhe ta parandalojnë rritjen e numrit të të vdekurve. "IKShPK-ja u bën thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve dhe organizatave publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Në veçanti, bëjmë

thirrje për zbatimin e rekomandimeve dhe respektimin e masave kufizuese për aktivitetet publike, përkatësisht kufizimeve për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

IKShPK-ja ka theksuar se grumbullimi i qytetarëve pa maskë dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-COV-2 është i pranishëm në mesin tonë. "Apelojmë te institucionet përgjegjëse, përkatësisht Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse, që ta mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës", është theksuar në njoftimin e IKShPK-së.

## Shqipëria furnizohet me 10 000 vaksina nga Rusia

TIRANË, 22 MARS (ER) - Në Shqipëri kanë mbërritur 10 000 doza të vaksinës ruse "Sputnik V" kundër sëmundjes Covid-19. Këto vaksina janë dhuratë nga Princi i Kurorës së Emirateve të Bashkuara, Muhammed Bin Zayed. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka thënë se në ditët në vijim priten



të arrijnë edhe sasi të vaksinave të tjera. "Së shpejti shuma të konsiderueshme vaksinash të tjera do të pasojnë, duke na krijuar mundësinë t'i rrisim fuqishëm numrat e vaksinimeve ditore, për të dalë së shpejti nga tuneli i gjatë i kësaj lufte të egër", ka shkruar Rama.

Rama disa ditë më parë ka thënë se Shqipëria nuk do të

pranojë vaksina ruse dhe kineze, megjithatë qeveria i hapi rrugë marrjes së vaksinave nga Rusia dhe Kina.

Ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, u shpreh në Aeroportin e Rinasit se në ditët në vijim do të mbërrijnë në vend vaksina të tjera, për të nisur një vaksinim masiv të popullatës për ta lehtësuar sezonin turistik.



# BQK-ja shënon Javën Ndërkombëtare të Parasë



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 22 MARS** - Pavarësisht prej situatës së krijuar nga pandemia, Banka Qendrore e Republikës e Kosovës (BQK) ka nisur organizimet në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parasë. Me gjithë sfidat e vazhdueshme që solli Covid-19, BQK-ja është e angazhuar në nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe duke pasur parasysh se sektori financiar është një ndër kontribuuesit kryesorë në ekonominë e Kosovës, edukimit financiar po vazhdon t'i kushtojë rëndësi të veçantë.

Përmes punës dhe angazhimit për avancimin e edukimit financiar, qytetarët kanë arritur t'i përmirësojnë njohuritë e tyre rreth koncepteve ekonomike dhe financiare, produkteve, shërbimeve, sfidave dhe rreziqeve, përmes marrjes së informacioneve, zhvillimit të aftësive dhe shprehive të tyre për të bërë zgjedhje të duhura dhe ndërmarrë veprime efektive për ta përmirësuar mirëqenien e tyre financiare.

Java Ndërkombëtare e Parasë

është një fushatë vjetore globale e ndërgjegjësimit për fëmijë dhe të rinj, në mënyrë që në moshë të hershme të sigurohen, t'i fitojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe sjelljet e nevojshme për të marrë vendime të duhura financiare. Kjo fushatë apo aktivitet shënohet në mbarë botën nga institucionet financiare, në mënyrë të ndryshme, derisa motoja e kësaj jave këtë vit është "Kujdesu për veten, kujdesu për paratë tua", e cila përmban një mesazh që vjen si ndikim i pandemisë në të gjithat fushat e jetës. "Ngritja e numrit të rasteve me Covid-19, posaçërisht javët e fundit, ka ndikuar që ta ndryshojmë agjendën tonë të paraparë për këtë javë dhe t'i përshtatemi respektimit të rregullave të përcaktuara për pandeminë. Sot do ta shënojmë hapjen e kësaj jave me grupe të vogla nxënësish të cilët do ta vizitojnë BQK-në. Të njëjtët kanë marrë pjesë në garën e BQK-së për ese, me temën e edukimit financiar dhe që janë përzgjedhur si esetë më të mira, për të cilët do të ndajmë disa çmime simbolike. Pastaj do të vazhdohet gjatë javës me

ligjërata e aktivitete të tjera virtuale në pamundësi të realizimit të aktiviteteve të parapara. Një aktivitet tjetër për të cilin dëshiroj t'i ftoj nxënësit e shkollave të mesme që të marrin pjesë, është që sot ne kemi shpallur një konkurs për ese me temën e motos së kësaj jave 'Kujdesu për veten kujdesu për paratë', i cili do të qëndrojë i hapur për një muaj, ku tri esetë më të mira do t'i fitojnë tri çmime. Qëllimi i këtij konkursi është që t'i nxitim të rinjtë e shkollave të mesme që të jenë më të informuar e edukuar rreth temave ekonomike e financiare", ka thënë guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, në lansimin e kësaj jave. BQK-ja nga viti 2013 është pjesë e këtij organizimi, i cili tashmë drejtohet nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). BQK organizon ngjarje e aktivitete të ndryshme me qëllim që të ndikojë në nxitjen e fëmijëve dhe të rinjve që të fitojnë njohuri ekonomike e financiare të cilat do t'ju nevojiten gjatë tërë jetës. Qëllimi i programit të edukimit financiar të BQK-së është që në

aktivitetet dhe materialet edukative t'i përfshijë të gjitha grupmoshat e qytetarëve të Kosovës, megjithatë fokus primar ka nxënësit e të gjitha niveleve të arsimin në Kosovë.

Vlen të përmendet një nga projektet konkrete që ka nisur BQK-ja dhe që lidhet me institucionalizimin e bashkëpunimit reciprok në fushën e edukimit financiar që vjen pas nënshkrimit të memorandumit me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në tetorin e vitit të kaluar. "Po ashtu, jemi pajtuar për mundësinë e përfshirjes së edukimit financiar në kurrikulën shkollore dhe konkretisht kemi përgatitur koleksionin prej pesë librash për klasat I deri V, i cili planifikohet të shpërndahet porsa të na lejojnë kushtet e pandemisë dhe do të mësohen në kuadër të lëndës 'Shkathtësi për jetë'. Përfshirja e edukimit financiar në kurrikulën zyrtare shkollore njihet si një nga mënyrat më efektive, të qëndrueshme, afatgjatë dhe të duhura për të arritur që njohuritë dhe shkathtësitë financiare të mësohen nga një generatë e tërë dhe në nivel

vendi. Po ashtu, kemi një numër projektesh në proces, për të cilat do të informoheni me kohë, të cilat konsideroj se do të kontribuojnë në të mirën e qytetarëve dhe marrjen e vendimeve të duhura financiare kundrejt produkteve dhe shërbimeve financiare. Gjithashtu, dua t'ju informoj që të gjitha aktivitetet materiale dhe konkurset në vazhdimësi i promovojmë edhe në faqen zyrtare apo në rrjetet sociale të BQK-së, andaj i ftoj fëmijët, nxënësit dhe të rinjtë që të na përcjellin qoftë përmes tyre", ka thënë guvernatori Mehmeti. Banka Qendrore e Republikës e Kosovës në kuadër të edukimit financiar dhe me qëllim të shënimit të Javës Ndërkombëtare të Parasë fton nxënësit e shkollave të mesme të Kosovës të marrin pjesë në konkursin për esenë më të mirë në fushën e financave dhe ekonomisë.

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parasë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka hapur konkursin për esenë më të mirë në fushë e financave dhe ekonomisë.



## KEDS-i angazhon mbi 400 punëtorë në terren pas motit të ligë

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Kompania Kosovare për Distribucion të Energjisë Elektrike (KEDS) ka angazhuar mbi 400 punëtorë në terren për të intervenuar në zonat e prekura pas motit të ligë që kaploi vendin. Sipas KEDS-it, që nga dita e djeshme dhjetëra ekipe janë gjithandej vendit që t'i sanojnë dëmet e shkaktuara në rrjet. "Ekipet po punojnë pa ndërprerë, me të gjitha kapacitetet, në mënyrë që konsumatorëve t'u rikthehet furnizimi me energji elektrike. Moti i ligë, i cili po vazhdon edhe gjatë ditës së sotme, ka shkaktuar dëme në rrjet. Zonat të cilat janë më të prekura nga dëmet në rrjet janë: Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe pjesërisht Prishtina dhe Mitrovica. Reshjet e vazhdueshme të borës kanë bërë që në zonat periferike dhe ato malore, depërtimi deri tek avaria e shfaqur në rrjet të jetë më i vështirë, por ekipet tona po bëjnë përpjekje maksimale që edhe në ato zona të sanohen dëmet dhe të rikthehet furnizimi me energji", thuhet në njoftimin për media.



KEDS-i është duke bërë monitorimin e rrjetit në kohë reale përmes programit "Kosovanet", ku evidentimi i

avarive po bëhet në kohë rekorde, ndërkaj përmes sistemit SCADA po mundësohet kontrollimi i nënstacioneve dhe intervenimi

më i shpejtë nga ekipet tona. KEDS-i u bën apel qytetarëve që të bashkëpunojnë me ekipet në terren dhe nëse shohin ndonjë

avari në rrjet ta raportojnë atë përmes Qendrës së Thirrjes në numrin pa pagesë: 0800 791 00 dhe rrjeteve sociale të kompanisë.

## Pezullohet përkohësisht greva e transportit të udhëtarëve, autobusët nisin qarkullimin



PRISHTINË, 22 MARS - Shoqata e Transportit Rrugor e Udhëtarëve ka pezulluar përkohësisht grevën në shenjë solidarizimi me qytetarët nga

moti i ftohtë. Kryetari i ShTUsë, Ruzhdi Kurtishaj, ka theksuar se pezullimi i grevës dhe protestës nuk do të thotë që heqin dorë nga kërkesat e

tyre. "Pezullimi i grevës dhe protestës nuk do të thotë që heqin dorë nga kërkesat tona, por ky vendim ka ardhur për shkak të motit të lig", ka thënë

në një konferencë për media. ShTU të premtën e kaluar në shenjë proteste ka parakaluar me autobusë në kryeqytet, ndërsa ndaljen e ka bërë para

objektit të qeverisë. Greva e Shoqatës e Transportit e Udhëtarëve ka filluar të mërkurën e javës së kaluar.

## Dita Botërore e Ujit, KRU 'Hidrodrini': Në kohë pandemie, rëndësia e ujit është dyfishë jetike



PEJË, 22 MARS (ER) - Me rastin e Ditës Botërore të Ujit, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" ka thënë se përdorimi dhe shpenzimi i ujit në kohë

pandemie është dyfish jetik. Sipas kompanisë KRU "Hidrodrini", shpenzimi racional i ujit ndihmon në parandalimin dhe transmetimin e virusit. "Uji na

duhet në çdo sekondë të jetës sepse uji është jetë. Mirëpo, në kushte pandemie, ju e dini se ofrimi i ujit të sigurt dhe kushteve të sigurta të higjienës dhe pastrimit janë thelbësore

për mbrojtjen e shëndetit të njeriut gjatë shpërthimeve të sëmundjeve infektive, duke përfshirë edhe shpërthimin e Covid-19", thuhet në njoftimin për media.



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (13)

# Takimi në zyrën e Enverit



Shkruan: Bedri ISLAMI

Së pari, përse EH u kujtua për hartimin e këtij plani kaq sekret dhe kaq masiv në vitin 1980? Në relatat midis dy shteteve kishte pasur ngrirje të plota marrëdhëniesh, gjendje të jashtëzakonshme, ulërima, dërgim agentësh, akte terrori në tokën shqiptare, një shkrirje të çastit në vitin 1956, pastaj përsëri akullim. Ishin dëshmuar edhe masakra të rënda ndaj popullit shqiptar në Kosovë e, megjithatë, asnjëherë nuk ishte ndërmarrë një plan i tillë sekret, i cili planifikonte, as më pak e as më shumë, sesa dërgimin e ushtrisë së shtetit shqiptar për çlirimin e viseve shqiptare në Jugosllavi. Pra, jo nuk kishte pasur asnjëherë asnjë plan të tillë, por për më tepër nuk kishte pasur asnjë tentativë të tillë. Në vitin 1980 klima mes dy shteteve nuk paralajmëronte ngjirje. Shteti shqiptar nuk kishte më asnjë aleat, ishin prishur marrëdhëniet me BS dhe me Kinën. Pra ishte një Shqipëri krejt fillikat, si kurrë ndonjëherë dhe, për më tepër, një Shqipëri me një gjendje ekonomike që po vështirësohej gjithnjë e më shumë. Me gjithë këtë akullim në lidhjet me botën e jashtme, përsëri EH i garantonte hartuesit e planit sekret të "Traktatit të Varshavës", nga i cili Shqipëria ishte larguar në vitin 1968, se nuk do të ndërhynte. Në këtë kohë, ndodhën ngjarjet e marsit dhe kjo ishte edhe koha, kur për herë të parë, qoftë edhe teorikisht, shteti shqiptar mendon të ndërmarrë diçka që, në fakt, i binte ndesh të gjitha konventave ndërkombëtare. Si u bë hartimi i këtij plani sekret, me emrin e koduar "Shpërthimi". Le të sjellim një pjesë nga intervista e ish-shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë shqiptare, Veli Llakaj.

## Takimi në zyrën e Enverit

Bisedën e filloi me pyetjen se si jeni ju andej nga Komanda e Përgjithshme, (se kështu e quante Enveri Ministrinë e Mbrojtjes), si janë shokët, po poshtë nëpër reparte si janë, si i keni lidhjet me ta, çfarë kërkesash imediate kanë dhe çfarë ndihme kërkojnë nga Komanda e Përgjithshme, si ia zgjidhni ju këto probleme, i keni mundësit apo jo etj. "Kërkoni ndonjë ndërhyrje nga shoku Mehmet se ky ua zgjidh

gjithçka, se është më i mirinformuar, më i lidhur me hallet e ushtrisë, pastaj vijnë shokët e tjerë e në fund vij edhe unë", -theksoi mes të tjerave Enveri. [...]

Duke dëgjuar këtë lloj përshkrimi apo panoramën që i bëme, ai më pyeti: "Si thoni ju të Komandës së Përgjithshme dhe të Shtatmadhorisë, mundet që ne të bëjmë një ndërhyrje ushtarake për çlirimin e popullsisë shqiptare në këto treva, për t'i çliruar një herë e përgjithmonë nga thundra revizioniste e fashiste, ashtu siç ndërhyrje edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare?"

Ky propozim më çuditi, por edhe më hutoi, dhe isha në vështirësi e dilemë, që përse nuk ia bënte këtë pyetje Mehmet Shehut, por mua? Jam i bindur se ata të dy këtë çështje mund ta kishin shoshitur disa herë dhe kanë rënë dakord, por tani, si duket, ka ardhur koha të konkretizimi dhe përgatitja e ndonjë plani operacioni luftarak.

Qëndrimi im ishte disi indiferent, por i trembur. Në moment nuk dhashë asnjë përgjigje, por thjesht mblodha supet, çka do të thoshte se nuk jam në gjendje t'i përgjigjem. Enveri menjëherë ndërhyri. "Përse heziton, çfarë të mundon, pse nuk ke besim!" Atëherë e mblodha veten dhe iu përgjigja: "Shoku Enver, në situatën aktuale të krijuar, kur regjimit serb po i digjet toka nën këmbë nga forcat kryengritëse të popullatës shqiptare kudo në trevat e banuara nga shqiptarët, edhe mund të ndërmerret një operacion i tillë, por ne nuk kemi atë fuqi jo vetëm goditëse, por as të shpejtësisë së mjeteve të blinduara ta bëjmë këtë në kushte kur në këtë situatë mund të ndërhyjnë Forcat e Traktatit të Varshavës të dislokuara në Hungari, Bullgari e Rumania, pra po ndërhyjnë këto forca, ne jemi të dështuar!".

Sepse, - vazhdova t'i flisja më tej Enver Hoxhës, - këto (Forcat e Traktatit të Varshavës) do të vijnë më shpejt se trupat tona jo vetëm në Gjilan-Prishtinë-Ferizaj-Mitrovicë-Klinë, por unë mendoj se në momentin kur ne të kemi hyrë në Prizren nga drejtimi i Kukësit dhe Hasit, e në Gjakovë-Pejë-Deçan nga drejtimi Tropojës, apo në Strugë nga drejtimi Librazhd-Rajcë etj. Forcat e Traktatit të Varshavës në bashkëveprim me forcat e ushtrisë jugosllave kanë mbërritur për afërsisht në Tharandë (Suharekë) Malishivë-Rahovec". Kurse në drejtim të Maqedonisë, - vazhdova unë më tej - që ne mund të futemi nga Rajca mbi Strugë ose nga Tre Portat e

Korabit drejt Kërçovës ose në çdo drejtim tjetër, forcat kundërshtarë na kanë marrë Kërçovën bashkë me divizionin e gjeneral Ibrahimit.

Pa mbaruar akoma argumentet që po jepja, Enveri më ndërpreu dhe më thotë: "Po sikur ta rregulloj unë me Mehmetin që Forcat e Traktatit të Varshavës të mos futen, a mund të futemi në luftë e të çlirojmë Kosovën?" Pashë i përqendruar, pa kuptuar fillimisht se ku donte të dilte, ndërsa më pas do të kuptoja disa gjëra që as më kishin shkuar ndërmend deri në ato momente që isha në krye të Shtabit të Përgjithshëm.

Isha përgatitur t'i raportoja Enverit për çdo problem në strukturat e ushtrisë, por nuk e kisha menduar se thirrja ime urgjente në zyrën e tij së bashku me Mehmet Shehun do të kishte një tematikë tepër të rëndësishme, për mua, të papritur! Gjithsesi, nën efektin e "garancisë" që më afroi Enveri me shprehjen: "Po sikur ta rregulloj unë me Mehmetin që forcat e Traktatit të Varshavës të mos ndërhyjnë, a mund të futemi e të çlirojmë Kosovën?", duhej të bëja llogaritë shumë shpejt e të përgjigjesha. Të them të drejtën u shushata fare, se si ka mundësi kur ne shaheshim përditë me revizionistët e të gjitha vendeve të Lindjes e në mënyrë të veçantë me ata sovjetikë, si mund ta rregullonin këta këtë çështje luftarake kaq kapitale! Pa u menduar fare, por me një analizë të shpejtë që bëra të raportit të forcave e situatës luftarake në luftën e pritshme, i përgjigjem: "PO!". Bëhet fjalë për më shumë se dy dekada e gjysmë më parë, e ndoshta, ky moment e kjo bisedë ka qenë i pari për mua të mësoj se ç'është politika, ku jo çdo gjë që thuhet e premtohet haptas, është e do të bëhet ashtu siç thuhet; përkundër, në të shumtën e rasteve, ndodh e kundërta!

Pasi e pranova këtë version, megjithëse jo shumë bindës për mua, duke menduar se këta

kërkojnë të më fusin në valle që të bëhet një plan i ndërhyrjes ushtarake për çlirimin Kosovës dhe pastaj shohim e bëjmë sipas situatave që mund të krijohen. Enveri më merr mendimin se sa kohë më duhen ta paraqes planin tek ai dhe Mehmeti për miratim. Unë u përgjigja se kjo varet se sa persona do të punojnë për hartimin e tij. Ndërhyn Mehmeti: "Do të punosh vetëm me një person dhe unë, (pra, Mehmeti, V. Ll.), do të jem në krye të këtij grupi pune". Kërkova 30 ditë kohë. Enveri më thotë: "Po të lëmë 45 ditë, por plani të jetë i argumentuar saktësisht e deri në çdo detaj nga ana ushtarake". Marrja e detyrës u bë fakt i kryer, ishte një detyrë e vështirë, jo e lehtë, por thellë ndjeva një gëzim e kënaqësi të pa provuar. Meqenëse më lejohej të bashkëpunoja vetëm me një njeri, nuk ishte e lehtë të zgjidhja e për më tepër të vendosja vetë. Kërkova se a kishin ata ndonjë mendim se me cilin do të punoja unë. Enveri më thotë: "Zgjidhe vetë!" Propozova nja tre persona, ndër kuadrat më të lartë e më të përgatitur ushtarakë të vendit. Pasi dëgjojnë, Mehmeti i thotë Enverit: "Do të punojë vetëm me Maliq Sadushin që është zëvendësministër i Mbrojtjes, është i aftë, konspirativ, ka mbaruar akademinë ushtarake "Frunze", ndërsa unë do të jem në krye të këtij grupi!". Mehmeti i kishte idhuj të gjithë ata ushtarakë që kishin mbaruar akademitë ushtarake "Frunze" dhe "Vorshillov", por Maliqi që i përzgjedhura i tij, edhe për faktin se ka qenë partizan i Brigadës 5 Sulmuese në çlirimin e Kosovës dhe e njihje shumë mirë terrenin, garanci kjo e domosdoshme për një planizim e zbatim të saktë të planit luftarak. Për mua, ishte një kënaqësi tepër e veçantë se do të punoja me Maliqin për hartimin planit për ndërhyrjen ushtarake në Kosovë, për faktin se ishim shokë, kolegë,

njiheshim mirë, si dhe ishte profesionalisht tepër i aftë.

## Fillimi i punës për përgatitjen e planit

Ajo natë, për mua, ishte një natë ankthi. Vrisja mendjen se si do të veprohej më tej, çfarë detyra do të merrja, si do ta filloja punën, çfarë vështirësih do të hasja, e shumë e shumë gjëra të tjera. Gjithçka kishte ardhur papritur, e tashmë suksesi i planit dhe operacioni i pritshëm varej nga ne.

Të nesërmen e asaj dite Mehmet Shehu vjen në zyrat e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, më thirri mua dhe shokun Maliq Sadushi, ku na precizoi detyrat përkatëse, na dha orientime shumë precize ashtu siç t'i jepte ai. Afërsisht na përcaktoi zonat e veprimeve luftarake të çdo korpusi që do të merrte pjesë në këtë operacion, brigadat e këmbësorisë, të tankeve, të artilerisë dhe llojeve të armëve e shërbimeve për çdo specialitet, afërsisht vendkomandën e grupit operativ të Shtabit të Përgjithshëm që do të drejtonte operacionin, disa vendkomanda rezervë në drejtimin e Maqedonisë e të Malit të Zi, vendkomandat e korpuseve e të brigadave, drejtimit e goditjeve kryesore për çdo drejtim, rezervat materiale në ushqim, veshmbathje e medikamente mjekësore etj. Na përcaktoi afërsisht edhe të gjitha njësitë ushtarake që do të merrnin pjesë në operacion, duke caktuar edhe njësitë sulmuese apo repartet e zbulimit që do të vepronin në terrenet më të vështira e që do të jepnin goditje rufe e në befasi. Pasi na dha detyrat e mësipërme, Mehmeti shtoi: "Unë kaq munda t'ju jap për sot, ju i shikoni dhe veproni me kompetencë vetë, ashtu si ta gjykoni dhe mos i qëndroni strikt këtyre që ju them unë".

(Vijon)





# KOSOVA NËN CIPËN E SERTË TË NJË ANGLEZI

John Hodgson, "E ardhmja në të shkuarën: Kujtime të Kosovës", Prishtinë, Cuneus, 2021



Shkruan: Ismail SYLA

1. John Hodgson, student i Kembrixhit (universiteti i themeluar më 1209), me traditë 812-vjeçare, me gjyshin inxhinier detar dhe të atin oficer të marinës mbretërore, një anglez nga ishulli i mjegullt, gjatë qëndrimit trevjeçar në Kosovë, u familjarizua me fatin e shqiptarëve të Kosovës, aq sa "kur NATO-ja hyri në luftë për çlirim-in e Kosovës, m'u duk sikur kishte hyrë në veprim ndërmarrja familjare" (f. 13). Ky njeri me ambicie akademike në fushën e linguistikës, me parapëlqim për sllavistikën, jeton në Kosovën që nga dhjetori 1980 deri në dhjetor 1983, si lektor i gjuhës angleze në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Fakultetin Filozofik të Kosovës, tash Filologjisë të Prishtinës. Se kujtimet e tij kanë vlerë të veçantë edhe në trafshin tim personal, është fakti jetësor që unë në periudhën 1979 - 1981 kam qenë student i Degës së Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, deri më 24 janar 1982, kur arrestohem dhe burgosem në Nova Goricë të Sllovenisë, në përpjekje për të dalë në përndim përmes Italisë. Kujtimet e Johnit i lexova dy herë dhe më shoqëruan me një sentimentalizëm të dyfishtë. Leximi i parë me efektin fillestar për saktësinë e vëzhgimeve dhe të përshypjeve të tij (pyetja te Mensa e Studentëve "kush ka bon", kënga "Ushton Gryka e Kaçanikut", tanku i 3 prillit 1981, oborret me mure dhe me thi - shqiptarët e krishterë, me thi dhe pa mure - serbët, antena e kanalit 11 e, në fakt, ishte për kanal 12, sofa, si disk, "zdenka", distinktivi me flamurin shqiptar në jakën e setrave etj.). Leximi i dytë do të jetë me komente më të zgjeruara në vijim.

2. John Hodgson që vjen nga një familje tipike angleze "nga New Castle, çerdhe e revolucionit industrial në veri të Anglisë" (11), nuk shpalos asnjë lloj arrogancë dhe prepotencë ndaj Kosovës, ndaj vendit, njerëzve dhe kulturës shqiptare. Ai vjen nga shkollimi në Kembrixh me "ndërtesa historike me barë të prerë si me manikyrt" (15) dhe sheh oborrin e Fakultetit Filozofik si "një yrt të tharë" (15), sheh rrugicat me puse, kon-

trastin midis fytyrës urbane të Prishtinës dhe pakujdesisë ndaj pastërtisë, shastiset nga "koncerti" me muzikën me defe në shkollën e Carrallukës (66), por në asnjë rast nuk i përçmon as nuk i konsideron si shprehje të jetës parake, primitive, por si dukuri që duhet marrë ashtu siç janë. Ky mirëkuptim është shprehje dhe cilësi e njeriut të ngritur në aspektin akademik dhe me thellësi intelektuale. John Hodgson nuk e gjen vetveten ashtu siç i përcakton anglezët shqiptari Ardian Vehbiu "popull flegmatik... (11), por kur ai e lexon veprën e Edith Durham, me të drejtë konstaton se në disa aspekte të mentalitetit shqiptarët nuk kanë evoluuar shumë, si përçarja, inati hakmarrja etj. Në fakt John Hodgson i përket anglezit sipas nobelistit Elias Canetti "një komb që nuk flet me fjalë të fryra për vetveten, e megjithatë vazhdon pa pikë dyshimi të tregojë se ndjenja kombëtare e tij është më e qëndrueshmja në botën e sotme (E. C. "Masa dhe pushteti", vëll. I, f. 242).

3. John Hodgson kur flet për Edith Durham, vëren se "nën cipën e sertë të asaj gruaje lexohej qartë një dashuri e flaktë për Ballkanin (45). Ky konstatim, po u përkthye me qëndrimin e tij mirëkuptues dhe human të shpalosur në kujtimet për Kosovën, të çon te kuptimi i parimit të jetës angleze që "ta gjesh zjarrin nën akull" (45). John Hodgson është dëshmitar okular i demonstratave të 11 e 26 marsit, 1 dhe 2 prillit 1981. Dhuna dhe shtypja brutale e demonstratave ishte mbresëlënëse për lektorin, i cili jep mozaikun e ngjarjeve si përjetues aktiv i tyre. "Një shtet evropian kishte nxjerrë tankset kundër qytetarëve të vet pa e vënë re askush. Në Kosovë nuk kishte qenë i pranishëm asnjë gazetar, korrespondent i huaj, kanal televiziv, analist" (70). Pas protestës madhështore të 1 prillit 1981, më 2 prill policia dhe i ushtria serbe reagoi me armë zjarri ndaj demonstruesve. Më 3 prill u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Në rrugët kryesore të zemrës së Prishtinës defilonin tetë tanket e Garnizonit të Prishtinës. John Hodgson i përshkruan bukur. "Te semaforët pashë tanksin e parë. Po zbriste nga mensa e studentëve, pikërisht aty ku kishte qenë post-blloku i parë. Dukej si dinosaur, i stërmadh, me lëvizje të ngathëta dhe të mundimshme, me blindat si luspa... Ishte një objekt hem i frikshëm, hem qesharak dhe gjithsesi primitiv. Sikur mishëronte në vetvete tërë

përgjigjen e shtetit jugosllav ndaj protestave në Kosovë" (57). Kur jemi te tanku simbolik dhe reprezentativ i Hodgson-it, unë jam dëshmitar i asaj parade armiqësore me tanke. Pak nën semaforët e Filologjikut në drejtim të Fushë Kosovës, një tank pësoi avari. Nuk kish gjë më komprometuese për fuqinë e tyre se ai tank i mbetur në udhë. Zymtësia e Qendrës së Studentëve, klima e rëndë nëpër ndërtesat e fakulteteve atmosfera e dhunës dhe kërcënimeve e bën Hodgson që Prishtinën ta emërtoj si "Pendrek City" (58).

4. Mësimdhënia dhe mësim zënia bën që John Hodgson në kujtimet e tij të evidentojë momente me vlerë rreth kulturës, gjuhës, traditave dhe përditshmërisë së jetës së shqiptarëve të Kosovës. Te gjuha shqipe ai dallon gjithë shtresëzimet. Gjuha e librave gramatikorë është në një anë. Gjuha e folur është në anën tjetër. Gjuha e muzikës është ndryshe në Radio Prishtinë, ndryshe në Festivalin e këngës në RTSH në një fund vit, kur autori e përcolli në televizorin bardh e zi. Autori ballafaqohet me të gjitha variantet e gjuhës: "nën shtresën e hollë të asfaltit gjallonte dheu i thellë i gjuhës popullore" (78), thotë ai, duke shtuar se jashtë gjuhës zyrtare ishte kodi i fshehtë i asaj popullore: "Ishte gjuha e njerëzve që njihja, që ata e përdornin për shprehjen e mikpritjes, për muhabet e humor" (76). Lektorin anglez dallon me mprehtësi përdorimin e barbarizmave në bazë të gjeneratave, te më pleqtë shprehjet orientale, të të tjerët shprehjet sllave (knjižica - librezës, slušalica - stetoskopit të mjekut etj.) Efekti i tingullor i gjuhës letrare shqipe nga Hodgson shprehet me një gjetje metaforike dhe krahasuese: "...gjuha letrare tingëllonte në veshin tim si diçka femërore, me bashkëtingëllore si trokitja e lehtë e takave të larta, ose tasteve të një makine shkrimi." (78). Në tërë këtë llojlojshmëri të niveleve dhe diskurseve, më së shumti e impresionon habiturja e gjuhës shqipe, e cila ka ngjashmëri vetëm me gjuhën sanskrite. Të kujtojmë, përmes Lasgush Poradecit vetëm dy shprehje të kësaj habitoreje: "Ardhka nusja! Rënka dielli!", si të themi me habi, shih, shih po vijka nusja, shih po nxejka dielli! Në këto kujtime nuk ke si të mos lësh mënjanë edhe gjuhën mimetike të autorit. Ku ma bukur se përkufizimi perifrastik i dimive të plakave "të veshura me funde voluminoze" të kafes turke si "zift i ëmbël që zihet në

xhezve prej tunxhi" (32) ose shprehja e zgjeruar pleonazmatike për kungullorin "pite në formën e një rrote të madhe të çmontuar në segmente" (102). Krahas niveleve dhe diskurseve të gjuhës, Hodgson vëren edhe aspektin dual të historiografisë në vitet 1980. Për të më e plotë dhe më e vërtetë është historia e ndaluar, që jeton në kujtesën e njerëzve se ajo zyrtare e censuruar. Në kasetat e këngëve të incizuara nga amatorët, e që shiten në tregun e Prishtinës, autori e nuhat, e ndien dhe e kupton pjesën e ndaluar dhe të vërtetën e historisë së shqiptarëve (këngët për Azem Bejtën, Bec Sinanin, Dan Derocin etj. f. 113).

5. Në këtë libër kujtimesh shihen edhe detaje të shumta që një mendjeje angleze i lënë përshypje të përditshme. Ky është depërtim i thellë në kulturën dhe mënyrën e jetës së tjetrit. Janë mbresëlënëse të gjitha evidentimet e John Hodgson, që nga shprehja kur porositet byreku, i cili hahet brenda lokalit "për këtu" (75) e deri te identifikimi i Shqipërisë me shprehjen metaforike "matanë gardhi". Po ashtu bie në sy fryma iluministe e Kosovës e epokës me universitet, ku vrapit drejt dijes dhe shkencës shihet si komponent e forcimit të identiteti kombëtar, e ku feja islame dhe hoxhallarët identifikohen me prapambetjen dhe mos emancipimin. Dallimi midis odës, xhamisë dhe kishës është shkollor (108). Përshkrimi metaforik i Pallatit të

Rinisë si "sallë sportive me brinjë bakri" i "Grand"-it si "hotel i kabashëm me pesë yje" (25), i lustraxhinjve të këpucëve që "bëjnë muzikë me furça" (26), i bufesë së Filozofikut ku shitej vetëm lëng boronice (të fabrikuar nga "Ereniku", vër. ime f. 31), kuptimi pezhorativ i fjalës "zorraxhi" për ata shqiptarë që flisnin turqisht, profesori i marksizmit me kritere të repta (Idriz Rexha, vër. ime), targa UR, për Ferizaj në fjalëkryqë, TM për Mitrovicën, e që nga shqiptarët në vend të simboleve të Titova Mitrovica, lexohej si Tahir Meha, një kryengritës nga Prekazi i Drenicës që luftoi kundër policisë jugosllave në ditën zyrtare të saj më 13 maj 1981, shitorja, "zadruga" INA (pikë karburant) dhe ambulanca si infrastrukturë e vendbanimeve të Kosovës (Kijeva, f. 127), duhani refuz, shqeto në kutitë e këmishave, sorrat dhe çafkat te plepat afër RTK-së, urretja ndaj shqiptarëve e palestinezit Maher, etj. etj. janë margaritarë, që kur evidentohen nga një i huaj, kanë peshë të jashtëzakonshme për dëshminë e përditshmërisë, e cila ashtu veç e veç, brenda një tërësie përben historinë, të shkuarën dhe të ardhmen.

6. Për brezin tim ky libër është margaritar. Çdo germë të tij e dimë sa ka saktësi. Ky shkrim është një falënderim publik për autorin, lektorin dhe mikun e shqiptarëve John Hodgson. Paçim rast për t'u njohur! Kjo është trajtë dëshirore, z. Hodgson.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:  
Priljeva: 27.03 2021

Njoftimi për shprehje të interesit	Emri i shkollës: "Emin Duraku"	4-404-15864
Komuna: Lipjan	Data: 23.03.2021	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/023-G/1.9	Pajisje teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Banullë, Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 6 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku", Banullë, Lipjan, më së largu deri më 31.03.2021
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Hazbi Sahiti  
Telefoni: 044/183-336  
E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:  
Priljeva: 22.03 2021

Njoftimi për shprehje të interesit	Emri i shkollës: "Ismail Luma"	4-404-15866
Komuna: Lipjan	Data: 23.03.2021	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/024-G/1.8	Pajisje teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Ismail Luma", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 12 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Ismail Luma" Lipjan, më së largu deri më 31.03.2021
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Driton Sadiku  
Telefoni: 044/741-608  
E-maili: driton.sadiku@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:  
Priljeva: 22.03 2021

Njoftimi për shprehje të interesit	Emri i shkollës: "Vllëzërit Frashëri"	4-404-15867
Komuna: Lipjan	Data: 23.03.2021	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/025-G/1.8	Pajisje teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Vllëzërit Frashëri", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 7 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Vllëzërit Frashëri" Lipjan, më së largu deri më 31.03.2021
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Avdi Azemi  
Telefoni: 049/852-692  
E-maili: avdiazemi@gmail.com

**NJOFTIM MBI ZVOGELIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "ContourGlobal Kosovo" L.L.C**

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuar, Aksionari i shoqërisë "ContourGlobal Kosovo" L.L.C., shoqëri me përgjegjësitë kufizuar, me numër unik identifikues 810093039 ("Shoqëria") ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË me datë 05.02.2021.

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar 32,431,000.00 Euro në 32,181,000.00 Euro, duke anuluar 250 aksione në vlerë totale prej 250,000.00 EUR

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"ContourGlobal Kosovo" L.L.C., Anton Çetta 5A, Prishtinë.



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë





Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Vita Group" Sh.p.k Hogosht, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin (ambalazhinin) e ujit natyral në Hogosht komuna e Kamenicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.04.2021 në ora 10:30 në hapësirat e restorantit "KALAJA" në Kopërnice komuna e Kamenicës, do të organizohet debat publik nga kompania "Vita Group" Sh.p.k Hogosht, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin (ambalazhinin) e ujit natyral në Hogosht komuna e Kamenicës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/72531740009?pwd=UkJrNXphcFJWS1RSS EJTL3ozMWhxdz09>

Zoom ID: 725 3174 0009

Paswordi: vneXJ8

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/giejpuneshpejte](http://www.facebook.com/giejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sale Elezovic shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.

► Fikri Hoxhaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Fahro Veliji shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.

► Fahro Veliji shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Vlora Milazim Imeri shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë me nr. 31, Bachelor i Gjeologjisë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

